



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 17.09.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.09.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik Roza Komani B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-6673-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-076-521, nxjerr:

**V E N D I M**

**1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Roza Komani B.I , e dt.09.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-6673-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-076-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 04.09.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

**2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 04.09.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Roza Komani B.I. me dt.09.09.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-6673-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-076-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 17.09.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj, i parë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e punëtorëve siç është kërkuar në FDT-ë, kurse sa i përket verifikimit të vërtetësisë së këtij dokumenti kjo nuk është në kompetencë e Autoritetit kontraktues;

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse menaxhimi i projektit nuk është e domosdoshme që të bëhet në mënyrë permanente;

Pretendimi juaj i tretë nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës ashtu siç është kërkuar në FDT-ë;

Pretendimi juaj i katërt, lidhur me kapacitetin teknik financiar nuk qëndron, sepse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi juaj i pestë lidhur me ekspertin e IT-ë nuk qëndron, , sepse është kërkuar licencë kurse Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar diplomë universitare të IT-së dhe Autoriteti kontraktues e ka marrë si ekuivalent;

Pretendimi juaj i gjashtë nuk qëndron , sepse kriteri i dhënies ka qenë çmimi më ulët, dhe plani dinamik i detajuar nuk është kërkuar në FDT-ë e po ashtu në FDT-ë, nuk është kërkuar asnjë dëshmi për këtë çështje( por një gjë e tillë është bartur gabimisht nga një projekt paraprak tek shablloni i draftit të kontratës);

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

